



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2018, ora 10:00

Drejtton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i materialeve të AMA-s, dërguar komisionit për shqyrtim:

- Propozimi i AMA-s “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.
- Propozimi i AMA-s për ndryshim në strukturën dhe organikën e AMA-s.
- Kërkesa e AMA-s drejtuar komisionit për mendim në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e listës së ngjarjeve me rendësi të madhe për publikun, si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar”.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista , Bujar Çela, Almira Xhambulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Anduel Xhindi (zëvendësues), Floida Kërpaçi (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të opozitës.

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi

Të ftuar:

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,

Erjona Rusmailli - drejtore e Burimeve Njerëzore në AMA

Sara Xhumbari – drejtore e Drejtorisë Juridike në AMA.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Meqenëse kuorumi është plotësuar, fillojmë mbledhjen Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Mbledhja e sotme zhvillohet me kërkesë të disa deputetëve të Partisë Socialiste, zonjës Ekonomi, zonjës Bello, zonjës Xhambulla, zotit Ulqini dhe zotit Beqiraj, që kanë propozuar që në rendin e ditës të jenë disa vendime të ardhura nga AMA.

Në fakt, unë nuk e kuptoj pse duhet ta bënit këtë kërkesë në momentin që ju e bojkotuat, me urdhër nga lart, mbledhjen e komisionit të paracaktuar në kalendar para një jave, kurse sot na paraqisni kërkesën për ta vendosur përsëri në kalendar. Unë nuk e kuptoj, sepse kjo nuk është as procedurë në amullinë totale, në panikun që ju ka pushtuar dhe nuk po dini se çfarë po bëni. Në momentin që është futur në kalendar, ju nuk keni asnjë arsye për të treguar se gjoja keni dëshirë të bëni mbledhje të komisionit.

Ju lutem, herë tjetër mos i bojkotoni mbledhjet e komisioneve parlamentare, sepse është e paimagjinueshme që maxhoranca të bojkotojë mbledhjet, për më tepër që bojkoti nuk shihet mirë edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë!

Gjithashtu, edhe në mbledhjen e fundit të Komitetit të Stabilizim –Asociimit kërkohej që proceset parlamentare të ishin të rregullta dhe zëri i opozitës të dëgjohej më shumë. Atëherë, ju lutem, mos i bojkotoni më herë tjetër mbledhjet, sepse nuk ia mbyllni dot gojën opozitës! Ne do ta gjejmë gjithmonë hapësirën për të folur. Mos përdorni këto artifica që janë të paimagjinueshme, të papranueshme dhe të dënueshme jo vetëm nga faktori i brendshëm, por edhe nga faktori i jashtëm. Ndaj, do t'ju lutem që herën tjetër të mos bëni gafa të tilla, por hajdeni, paraqituni! Mos merrni më urdhra absurdë, por të procedojmë normalisht në një mbledhje komisioni, sikurse parashikohet në kalendar.

Meqenëse sot kemi disa vendime të sjella nga AMA, pra janë çështje që kanë të bëjnë edhe me mediet, unë doja të parashtroja dy çështje, që në këndvështrimin tim janë tejet të rëndësishme, sepse kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes, me lirinë e medias, me lirinë e shtypit, si një prerogativë edhe për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Para disa ditësh, në mënyrë skandaloze, në mënyrë flagrante, me urdhër direkt të Kryeministrit është mbyllur një portal satirik *kryeministri.com*. Brenda disa orëve AKEP-i ka marrë urdhrin nga punonjësi i Kryeministrit dhe e ka mbyllur në mënyrë të paligjshme këtë portal satirik vetëm sepse vinte në lojë Kryeministrin, ministrin e Brendshëm apo emërimet e Kryeministrit për ministër të Brendshëm, duke paraqitur edhe disa kritere satirike.

Unë mendoj se të gjithë ne, anëtarët dhe deputetët e këtij komisioni, duhet të reagojmë, sepse nuk mund të censuroni, nuk duhet të censuroni, është flagrante dhe e papranueshme që Kryeministri të japë një urdhër dhe AKEP-i të mbyllë, në mënyrë të paligjshme, një portal vetëm sepse u tall me Kryeministrin dhe me ministrin e Brendshëm.

Çështja e dytë që unë dua të ngre ka të bëjë me një ngjarje shumë të rëndë, që ka ndodhur në datën 26 maj, pra gjatë protestës së opozitës.

Kryeredaktori i gazetës “Rilindja Demokratike”, zoti Bledi Kasmi, është goditur në mënyrë të qëllimshme në kokë nga forcat speciale. E them “në mënyrë të qëllimshme”, sepse nga fotot dhe videot që ne kemi parë, forcat e policisë janë afruar në mënyrë të qëllimshme për ta goditur kryeredaktorin e gazetës opozitare, “Rilindja Demokratike”, duke i shkaktuar atij plagë të thella.

Ja ku e keni fotografinë, ku dallohet qartë kryeredaktori i gazetës opozitare “Rilindja demokratike”, i cili është goditur me urdhër të Ramës dhe ministrit të Brendshëm. Shikojeni si e kanë goditur! Unë e kam shoqëruar vetë në spital dhe ai ka pasur plagë të thella, ku i janë bërë 10 qepje në kokë!

Ne, deputetët opozitarë të këtij komisioni, kemi hartuar edhe një deklaratë, të cilën unë do t’ju lexoj dhe më pas do t’ju shpërndaj për ta firmosur. Unë ju ftoj edhe juve ta firmosni, sepse të gjithë ne duhet të përpiqemi të luftojmë për lirinë e medias, për lirinë e shprehjes dhe për lirinë e shtypit në Shqipëri.

Atëherë, kjo është deklarata të cilën unë do t’ju lexoj dhe më pas do t’ju shpërndaj të gjithë deputetëve të këtij komisioni.

Deklaratë: “Dhuna policore ndaj kryeredaktorit të gazetës “Rilindja Demokratike”, zotit Bledi Kasmi.

Ne, deputetët e opozitës të Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, dënojmë me forcë dhunën policore ndaj gazetarit Bledi Kasmi, kryeredaktor i gazetës “Rilindja Demokratike”, media e parë e shtypit të lirë pas rrëzimit të regjimit komunist, e botuar nga Partia Demokratike. Gazetari Kasmi është goditur disa herë me shkopinj gome nga forcat

speciale të policisë, pak minuta pasi kishte raportuar në versionin *online* të “Rilindja Demokratike”, në protestën e opozitës të datës 26 maj 2018, për dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili akuzohej publikisht se kishte favorizuar vëllain e tij, i dënuar në Itali në vitin 2012 për trafik të lëndëve narkotike dhe pjesëmarrje në organizatat e krimit të organizuar.

Kryeredaktori i gazetës opozitare, zoti Bledi Kasmi, mori plagë të rënda në kokë dhe u dërgua me urgjencë në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë, por me një sjellje tipike të policisë sekrete qeveria urdhëroi manipulimin e provave të dhunës së ushtruar ndaj gazetarit edhe në disa medie pranë maxhorancës. Në përpjekje për t’u shpëtuar skandaleve qeveritare, drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, u urdhërua të intimidonte mjekët e Spitalit të Traumës për të manipuluar raportin mjekësor. Pavarësisht presionit dhe shantazheve, mjekët nuk u trembën dhe raportuan me profesionalizëm se plagët në kokën e gazetarit u shkaktuan nga goditjet e forta të shkopinjve prej gome.

Si deputetë të komisionit parlamentar përgjegjës për çështjen e medieve, duke vlerësuar seriozitetin që paraqet ky rast i rëndë dhe rëndësinë e medieve të lira dhe të pavarura, kërkojmë:

1. Thirrjen me urgjencë të një seance dëgjimore me kryeredaktorin e gazetës “Rilindja Demokratike”, zotin Bledi Kasmi, ditën e hënë, datë 4 qershor, ora 11:00.

2. Zbardhjen me përparësi të kësaj ngjarjeje të rëndë për lirinë e shtypit dhe sigurinë e jetës së gazetarëve.

3. U bëjmë thirrje Kryeministrit, Edi Rama, dhe ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, të dënojnë dhunën policore ndaj kryeredaktorit të gazetës opozitare, Bledi Kasmi, dhe të distancohen menjëherë nga çdo akt dhune, shantazhi dhe intimidimi që u bëhet gazetarëve dhe punonjësve të medias.

Përsëritim deklaratën e organizatës ndërkombëtare “Reporterët pa kufij” dhe të Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë, të cilët dënuan dhunën dhe u solidarizuan me kolegun e tyre gazetar, zotin Bledi Kasmi.

Bëjmë thirrje që këtij solidarizimi t’i bashkohen edhe institucionet europiane dhe organizatat ndërkombëtare, që mbrojnë lirinë e shtypit dhe të drejtat e gazetarëve.

Në cilësinë e deputetëve, anëtarë të komisionit parlamentar që mbulon fushën e medias, do të kërkojmë që Shqipëria, si vend anëtar i OKB-së, të mbështesë nismën e “Reporterëve pa kufij”,

për të emëruar një përfaqësues të posaçëm në Kombet e Bashkuara për sigurinë e jetës së gazetarëve.

Unë po ua kaloj shkresën të gjithë anëtarëve të këtij komisioni për ta firmosur.

A ka ndonjë që kërkon ta marrë fjalën për diskutime apo për procedurë?

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit, kryetare!

Ju sollët para komisionit dy raste të abuzivizmit të pushtetit me medien, një rast është urdhri i Kryeministrit për të mbyllur një nga portalet satirike *Kryeministria.com* dhe rasti tjetër është ai i ushtrimit të dhunës ndaj gazetarit të RD-së, i cili ishte në krye të detyrës në protestën e 26 majit.

Në fakt, kam konstatuar dhe kam hapur edhe bazën ligjore mbi të cilën AKEP-i pretendon mbylljen e portalit dhe AKEP-i nuk ka kurrfarë të drejte ligjore në ligjin për komunikimet elektronike, nuk i lë hapësirë, sepse ligji që rregullon mbylljen e portaleve është ligji për tregtinë elektronike, për ndryshimet e të cilit kemi pasur një debat. Vendimi i AKEP-it është krejtësisht absurd, antiligjor dhe është një shkelje totale e ligjit, është një urdhër politik absurd, i cili është përsëritur, pasi edhe në rastin e *hashtagut* kemi pasur të njëjtin fenomen. Rasti më ulëritës, në fakt, është goditja e gazetarit të Rilindjes Demokratike, zotit Kasmi, me justifikimin që nuk ka qenë në krye të detyrës dhe këtu bëhet një gabim i madh. Gazetari është si mjeku, gazetari është gazetar gjithmonë në 24 orë të tij dhe pacienti i tij normal është lajmi. Të godasësh një figurë publike se nuk është njohur?! Jo, goditja, edhe nga pamjet video, ishte e targetuar, e qëllimshme, e drejtuar dhe e orientuar dhe kjo nuk është rastësi, sepse edhe rasti i portalit dhe ai i fundit u bashkohen rasteve të tjera. Kjo tregon qartë se ky Kryeministër dhe kjo qeverisje kanë një problem shumë të madh me artikullimin e së vërtetës, sepse përgjatë gjithë kohës kjo e vërteta jonë për implikimin e qeverisë në trafikun e drogës, për bashkëpunimin e qeverisë me krimin nuk është një e vërtetë e sotme, nuk është një e vërtetë e rastit, është një e vërtetë disavjeçare, e cila është munduar të fshihet, të goditet, t'i mbyllet goja edhe gazetarisë, edhe politikës. Kryeministri kur nuk arrin dot t'u mbyllë gojën, dërgon kasnecët e tij, dërgon strukturat shtetërore. Kështu ka ndodhur me Telnis Kuqin para 4 vjetësh, kur denoncoi avionët e drogës në Gjirokastrë. Ky gazetar, në pamundësi për të pasur qetësi për familjen e tij, në pamundësi për të ushtruar profesionin e tij, është larguar nga Shqipëria. Kërcënimet kanë vazhduar për vite rresht për aktin që ai bëri për deklamimin e së vërtetës. Raste të tilla ku Kryeministri nuk u mbyll dot gojën, kërkon t'i përçmojë gazetarët, janë të pafundme, janë “kazan”, i ka sharë direkt, ka realizuar dhunë verbale dhe kur nuk realizon dot

dhunën verbale, kërkon shkarkimin e tyre nga puna. Këtë e ka bërë me Alida Totën, këtë ka bërë me gazetarët investigues të “Publicus” dhe këto janë raste reale. Kur nuk ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë, i detyron të largohen nga Shqipëria, siç ishte rasti i Atikës dhe i Gert Xhajës, sikurse ka edhe raste të tjera, të cilat ne i kemi trajtuar në këtë komision dhe kjo sjellje e tij është e pandalshme. Unë kërkoj që ne, si komision, të dalim me një rezolutë, madje të dalim me një qëndrim, i ftoj edhe kolegët e maxhorancës, pasi ne nuk jemi komisioni i Kryeministrit, por jemi specifikisht Komisioni i Medies dhe është në detyrën tonë ekzistenciale që jo vetëm të ruajmë ligjin dhe zbatimin e ligjit, jo vetëm të miratojmë ligje, por të mbrojmë edhe të drejtat e gazetarëve si pjesë e fjalës së lirë dhe si pjesë e së vërtetës.

Prandaj, oferta ime është e qartë, e saktë dhe si rrallëherë që ju nuk e keni bërë, madje shpesh jeni larguar në seancat dëgjimore që kemi kërkuar me këta gazetarë, kërkoj prononcimin tuaj. Të mos bëjmë sikur këtu bëjmë vetëm ligje, pasi duket sikur bëjmë cirk. Të flasësh për ligje në këtë parlament dhe në këtë legjislaturë, mua më duket si të lësh litarin në shtëpinë e të varurit. Këtu është katandisur parlamenti, sepse sot ligji është ekzekutuar, ligji është varur nga ju si maxhorancë. Nuk ka ligj, ka vetëm Maliq. E them këtë, sepse ka vetëm një ndryshim, nëse para viteve ‘90 ju me ligjin ekzekutonit dhe varnit njerëz, sot keni ndryshuar metodë, me njerëz specifikë që i dërgoni në institucione, varni dhe ekzekutoni ligjin. Prandaj nuk ka ligj në Shqipëri, prandaj ndodhin të gjitha këto fenomene që kanë ndodhur, prandaj kemi krizë politike, krizë të sistemit të drejtësisë, prandaj kemi krizë sociale. E vetmja zgjidhje, është zgjidhja politike.

Unë shoh që ligji nuk zbatohet dhe është varur. Nëse do të kishte ligj sot ish- ministri i Brendshëm nuk do të ishte i lirë. Në fakt, mënyra si u procedua ishte kronikë e një vdekje të paralajmëruar. Ajo që ka vdekur sot është drejtësia, madje e vdekur dhe e pakallur. Dëshmitari iku, dëshmitari kryesor u ekstradua në mënyrë të paligjshme, u pushua çështja ndaj Orest Sotës, u shkatërruan të gjitha provat dhe, në fund, pas ridhënies së pasaportës, iu dha liria. Ajo pjesë lirie që ishte brenda një teatri gjigant me dorëzim imuniteti, që gjoja e kërkonin ndërkombëtarët, e kërkon integrimi e të tjera është thikë ndaj hapjes së negociatave të Shqipërisë dhe kronikë e paralajmëruar e vdekjes së drejtësisë. Është edhe rasti tjetër i ministrit aktual. E njëjta procedurë po ndiqet, po shkatërrohen provat, vëllai i ministrit dërgohet në mënyrë absurde, pa asnjë procedurë ligjore jashtë Shqipërisë. I kanë regjistruar zërin, por askush nuk e di se zëri i kujt është regjistruar, si është regjistruar, ku është regjistruar. Nuk janë kryer procedimet më të thjeshta që çdo jurist dhe parlamentar i di, dorëzimi i mjeteve dhe telefonave e të tjera për të realizuar

verifikimin e së vërtetës, e cila duhet thënë, meqenëse jemi te pjesa e gazetarëve, nuk ishte pjesë e përgjimit të realizuar nga një forcë politike, ishte një investigim gazetaresk, prandaj gazetari që ka realizuar atë punë sot ka një presion të jashtëzakonshëm, kërcënim për jetën e tij, madje edhe në forma të ndryshme. Por askush nuk reagon, asnjë institucion. Pse? Në Shqipëri është varur ligji, nuk ka ligj për njerëzit e thjeshtë, nuk ka ligj për kuksianët, nuk ka ligj për ata që luftojnë çdo ditë për bukën e gojës. Ata duhet të qëndrojnë në burg, ndërsa pjesa e elitës së politikës duhet të jetë jashtë, duhet të japë mend, madje duhet të bëjë edhe ligje. Prandaj, sot kemi humbur funksionin kryesor të bërjes dhe respektimit të ligjit. Nuk mund të vazhdojmë në këtë mënyrë, duhet patjetër të ketë një zgjidhje politike.

Unë doja t'ju kërkoja që t'i pushoni ato boritë e shëmtuara që opozita po pengon integrimin, po pengon çeljen e negociatave me veprimet e saj, sepse, në fakt, opozita po artikulon të vërtetën. Po e vërteta nuk e pengon integrimin. Nuk mundet kurrësi një e vërtetë ta pengojë hapjen e negociatave apo integrimin e Shqipërisë, por çeljen e negociatave e dëmtojnë pikërisht moszbatimi i ligjit, shkalla e lartë e korrupsionit, krimi në nivele më të larta. Këtë thonë raportet ndërkombëtare të Departamentit Amerikan të Shtetit. Shqipëria është vend transit kryesor i narkotikëve të fortë, është vend kryesor i trafikimit të kanabisit. Kjo është e vërteta, e cila na ndihmon të reflektojmë.

Ju qëllimisht realizoni akte që e pengojnë çeljen e negociatave, sepse, në fakt, keni ndryshuar vetëm pozicionin, keni qenë dikur në opozitë dhe bënë të njëjtën gjë, sot jeni në maxhorancë dhe bëni të njëjtën gjë në format dhe mënyrat e ndryshme. Më parë shpikët Griseldën, qarkun e Fierit, nuk votuat Kodin Hekurudhor, sot realizoni liri për akuza shumë të rënda, ndërsa njerëz me akuza shumë të lehta janë në burg.

Ju mendoni se bota nuk ka sy dhe nuk i sheh këto veprime? Ndërkohë, nuk jepet as dorëheqje, që është morale dhe politike, dhe në konflikt të hapur interesi me ligjin themelor, siç është ligji antimafia.

Ne këtë kemi mundësi ta deklarojmë në këtë komision. Ne bashkë me qytetarët kemi dëshmuar se në axhendën tonë kryesore është integrimi europian i Shqipërisë. Ju keni axhendë tjetër, por ne do të vazhdojmë axhendën tonë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Zotërinj deputetë, ju ftoj të bashkoheni me shqetësimin tonë për çështjen e mbylljes së portalit *kryeministri.com*, sepse ajo çka ka ndodhur është edhe më keq se një mbyllje. AKEP-i me një urdhër të paprecedent u ka kërkuar të gjitha kompanive të internetit të bllokojnë aksesin në këtë faqe. Ndaj ne, deputetët e opozitës, do të kërkojmë të na shpjegohet nga AKEP-i pse është ndërmarrë ky veprim i paprecedent. Gjithashtu, do të kërkojmë edhe një dëgjese në seancë dëgjimore me drejtuesit AKEP-it për të na sqaruar në detaje, kush e ka dhënë urdhrin dhe pse e ka dhënë. Është censurë, e cila nuk dëshmon gjë tjetër veçse rënien në autoritarizëm.

Po, zoti Fidel.

Fidel Ylli – Unë do të flas shkurt. Sot kemi mbledhjen e komisionit dhe do të donim që kryetari i AMA-s të raportonte për projektligjin e ndryshimeve dixhitale.

Meqë në komision kanë ardhur deputetë të nderuar nga grupi juaj parlamentar, do t'ju kërkoja që këtë konferencë shtypit ta bënit te Partia Demokratike. Nëse doni ta bëni në komision, ne jemi të detyruar t'ju respektojmë, të gjithë mund të flisni...

Albana Vokshi – Fidel, nuk është konferencë për shtyp. Ja ku i keni...

Fidel Ylli – Të lutem, mos më ndërprit! Unë nuk ju ndërpreva.

Albana Vokshi- Kjo nuk është konferencë për shtyp.

Prononcohu një herë të vetme!

Fidel Ylli- Ju lutem, a do të më lini të flas? Nuk je ti Zoti, se ke mikrofonin në dorë!

Albana Vokshi - Mos bërtit! Pse e keni humbur qetësinë ju kështu?

Fidel Ylli – Si të mos bërtas? Kush jeni ju, jeni Zoti? Ju jeni kryetare dhe jeni njëlloj si unë. Prandaj, dëgjo se të dëgjova gjysmë ore!

Albana Vokshi- Mos bërtit!

Fidel Ylli - Do të bërtas se jam sportist dhe kam adrenalinë, nuk jam pulë.

Albana Vokshi - Mos flisni absurditete!

Fidel Ylli - Mbaroni konferencën e shtypit, ne do t'ju dëgjojmë.

Albana Vokshi - Ne do të flasim për çdo gjë.

Fidel Ylli – Blendi Kasmit i uroj shërim të shpejtë! Detyrat e gazetarit ai i di më mirë se ne të gjithë, e di se ku duhet të rrijë gazetari, por ju pasi dështuat në mitingun që bëtë, shkuaft futët kokën te policia, hoqët baxhën që të bënit këtë zhurmë. Kjo është ajo që bëtë ju.

Albana Vokshi – Pse dhatë urdhër të qëlllohej Bledi Kasmi?

Fidel Ylli – Po ata policët që hanë gurë, a janë bij nënash?

Kush i urdhëroi ata që të bënin dhunë atje?

Albana Vokshi – Si mundet ju të mos prononcoheni? Për çfarë vini këtu, se janë çështje të lirisë së medies!?

Fidel Ylli – Më lër mua të mbaroj! Ja për çfarë kemi ardhur ne këtu...

Albana Vokshi – Duhet t'i mbroni gazetarët.

Fidel Ylli – Ne do t'i mbrojmë gazetarët, por gazetarët të bëjnë punën e tyre, ashtu si edhe ju...

Albana Vokshi – Duhet të mbroni lirinë e fjalës.

Kështu e mbroni ju lirinë e fjalës?

Asnjëri prej jush nuk guxoi të prononcohej. Për çfarë vini këtu?

Fidel Ylli – Tani, a do të më dëgjosh mua të mbaroj?!

Albana Vokshi – Po mbarove! Çfarë? Ishe sportist...

Fidel Ylli – Sepse janë vrarë deputetë në bulevard...

Albana Vokshi – Kush qenkan këta?!

Fidel Ylli – Po, more, por janë plagosur... Janë vrarë gazetarë. E dini shumë mirë ju.

Albana Vokshi – Kush i çoi ata?! Kryetari yt i çoi!

Fidel Ylli – Gazetari i ABC-së ku e hëngri plumbin?! Prandaj të mos i hyjmë kësaj...

Albana Vokshi – Prononcohu çfarë ke për të thënë dhe vazhdojmë... I çoi mish për top kryetari yt...

Fidel Ylli – T'i lëmë deputetët të mbarojnë, të flasin çfarë të duan, se kanë të drejtën e tyre...

Albana Vokshi – Do të flasin, se nuk ua jep ti lejen, por e kanë këtë të drejtë me Rregullore. Nuk ua jep ti lejen...

Fidel Ylli – Nuk mund të na e ktheni komisionin në konferencë shtypi! Dakord?!

Albana Vokshi – Ju bëni mirë të mos bojkotoni, se është turp i madh.

Fidel Ylli – Asnjëherë nuk bojkotojmë. Absolutisht...

Albana Vokshi – Mos bojkotoni! Herën e fundit, herën e parafundit, se është një marrëzi...

Fidel Ylli – Ne kërkuam një pushim dhe u kthyem e...

Albana Vokshi – Nuk e kuptoni se çfarë po bëni. Ju ka kapur paniku, prandaj urdhëroni dhunën...

Fidel Ylli – Prandaj, do t'ju lutem shumë, zonja kryetare, konferencat e shtypit bëjini te PD-ja, keni banakë televizivë sa të doni...

Albana Vokshi – Konferencat i bëjmë atje, mbledhjet i bëjmë këtu. Dëgjoni dhe reagoni! Mos u bëni palë!

Fidel Ylli – Kjo vetëm mbledhje nuk është. Unë e kuptoj që deri në datën 28 qershor kjo situatë do të jetë këtu.

Albana Vokshi – Distancohuni nga dhuna!

Fidel Ylli – Pasi Shqipëria të hapë negociatat, ju do të qetësoheni...

Albana Vokshi – Ju jeni arsyeja dhe ju po e mbani peng...

Fidel Ylli – Sepse deri më 28 qershor ju do të bëni të pamundurën. Edhe gazetarët do t'i çoni të bëjnë dhunë, pra të gjithë...

Albana Vokshi – Ne po ju ndihmojmë të reagoni që të plotësoni kushtet...

Fidel Ylli – Ne jemi këtu përballë jush, për të pranuar ato që janë për të pranuar.

Albana Vokshi – Kështu po e fusni ju Shqipërinë?

Fidel Ylli – Të mos shkojë gazetari atje të bëjë dhunë. Gazetari të rrijë atje të raportojë...

Albana Vokshi – Turp i madh!

Fidel Ylli – Sigurisht, shkoi e mori hekurat dhe nga ta njihte polici?!

Albana Vokshi – Ndalni dhunën! Ndalni censurën!

Fidel Ylli – I uroj të shërohet sa më shpejt dhe të bëjë detyrën, siç e ka bërë!

Albana Vokshi – Hiqni ministrin e Brendshëm, sepse vetëm atëherë do të keni shanse...

Fidel Ylli – Mos bëni këtu propagandë! Do t'ju lutem, Albana, mbaroni, që ne të bëjmë mbledhjen e komisionit, sepse po pret zotëria atje. Ai ka ardhur dy herë dhe ne nuk po bëjmë mbledhje komisioni.

Albana Vokshi – Fole, tani do t'ia kaloj fjalën Valit. Do të flasim për çdo shqetësim, sepse vetëm kështu do të filloni të reagoni...

Fidel Ylli – Do të flas sa të dua unë dhe nuk të marr leje ty se sa do të flas. Dakord?

Albana Vokshi – Ndal dhunën! Hiqni Xhafajn, sepse vetëm kështu keni shanse. Ju po na mbani peng të gjithëve...

Valentina Duka – Edhe një herë, i kërkoj falje drejtorit të AMA-s, sepse u bë dy herë që është këtu, por ka çështje të tjera më të rëndësishme që duhet të diskutohen në komision. Unë, me përgjegjësi të madhe qytetare dhe politike, sepse jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë dhe anëtare

e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, por edhe me përgjegjësinë e madhe të një pedagogeje universiteti, sepse Bledi Kasmin e kam pasur student dhe ka qenë një student shumë i mirë i gazetarisë, dëshiroj të dënoj dhunën e ushtruar nga policia, sepse ai nuk po tundte hekurat e Ministrisë së Brendshme, por ishte duke bërë detyrën e tij si gazetari i një gazete shumë të rëndësishme politike, me një emër jashtëzakonisht të rëndësishëm “Rilindja Demokratike”.

Zoti Fidel, “Rilindja demokratike” është gazeta që ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm që kur doli, më janar të vitit 1991, jo vetëm për rrëzimin e komunizmit, por për t’u hapur rrugë zhvillimeve të reja demokratike në Shqipëri. Ajo është lexuar si Bibël në familjet e shqiptarëve. Bledi Kasmi, qëkur ka mbaruar studimet, ka qenë gazetar te “Rilindja Demokratike” dhe ka 13 vjet që nuk është gazetar i zakonshëm, por është kryeredaktori i “Rilindjes Demokratike”. Të parët që reagueshan (nuk reagoi as Kryeministri, as ju, si anëtarë të këtij komisioni), të cilët dua t’i falënderoj, ishin “Reporterët pa kufij”. Ata, më anë të një statusi në *Twitter*, i kërkuan Kryeministrit të Shqipërisë të kritikonte, të dënonte dhunën dhe të merrte përgjegjësitë e tij, që organet ligjvënëse në Shqipëri të dënonin dhunën dhe ai që ka ushtruar dhunën, të marrë përgjegjësitë. Nëse e ka ushtruar polici... Mediet tuaja filluan të tregonin se dikush nga protestuesit e ka goditur me dhunë. Jo, atë e ka goditur polici, pra ka goditur gazetarin në krye të detyrës.

Të nderuar deputetë, shteti është në rënie të lirë. Ministrat tuaj nuk janë në qeverisje. Ministrat tuaj nuk janë në Tiranë. Vendi drejtohet nga kryeqyteti... Ministrat tuaj janë ose për turizëm, ose për vizita gjysmëturistike dhe gjysmëzyrtare jashtë shtetit. Kur ndodhen në Tiranë, ata shkojnë nëpër rrethe duke organizuar disa tubime tipike *Made in Albania*, që i quani dëgjesa me qytetarët. Gjatë gjithë kësaj kohe kam hapur manuale të sistemeve të qeverisjes, kam naviguar në internet për të parë se si qeveris pozita në Kosovë, si qeveris pozita në vendet ballkanike, në Europë dhe nuk ka në asnjë vend të botës që pozita të organizojë tubime me qytetarët, të cilat janë karakteristika të fushatave elektorale, karakteristika të opozitës dhe jo të pozitës. Atje dëgjoni njerëz fakirë, ku gjysmën e tubimeve e keni të mbushur me njerëz nga administrata, merrni ndonjë njeri t’ju bëj pyetje dhe mendoni se ua zgjidhët të gjitha hallet: papunësinë, drogën, krimin dhe emigracionin atyre njerëzve. Këto tubime janë vërtet të papara në ndonjë vend tjetër. Vetëm në Shqipëri ndodh që ju dhe Kryeministri organizoni dëgjesa me qytetarët. Nuk e di nëse ministrave dhe Kryeministrit u mbetet kohë të firmosin shkresat zyrtare, sepse nuk rrinë në zyrë. Duket se Tirana është në dorë të opozitës, ku opozita bën lajm nëpër komisione, opozita bën lajm në parlament, opozita bën lajm në rrugë.

Po ju them se të gjithë kemi qenë në atë miting, në atë manifestim të madh, i cili nuk ishte aq i vogël sa mendoni ju dhe e gjithë Shqipëria ishte në shesh kundër krimit me kollare, kundër papunësisë, kundër varfërisë dhe kundër qeverisjes suaj jashtë mase të keqe.

Ne do të jemi këtu dhe kemi vendosur që këtë muaj të mos bëjmë zhurmë, sepse duam që negociatat të hapen më 28 qershor dhe, nëse nuk hapen, përgjegjësinë e mban qeveria, maxhoranca dhe jo opozita. Ne jemi këtu që të hapen negociatat, jo për ju, as për ne, por për shqiptarët, për djemtë dhe fëmijët e shqiptarëve që janë shpërndarë si zogjtë e korbit nëpër Europë, të cilët nuk kanë vende pune në Shqipëri, kanë mbetur pa bukë dhe rrinë me orë të tëra radhëve të postave dhe bankave për të tërhequr atë ndihmë të vogël që u jep qeveria. Prandaj, ju bëj thirrje juve që t'i bëni ju thirrje qeverisë që të punojë. Ju bëj thirrje të firmosni deklaratën tonë kundër dhunës së gazetarit dhe ta merrni në dorë ashtu siç duhet qeverisjen e vendit, se përndryshe opozita po bëhet gati. Ju nuk dini të qeverisni dhe Shqipëria meriton një qeverisje shumë më të mirë se juaja.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Fjalën e ka Romeo Gurakuqi. Të përgatiten deputetët Kejdi Mehmetaj dhe Klevis Balliu.

Romeo Gurakuqi-Faleminderit, kryetare!

Duke qenë se prej më shumë se një muaji në seancën plenare, për shkak të përdorimit të rreptë dhe të paarsyeshëm të procedurës parlamentare nga ana e Kryetarit të parlamentit, është bllokuar disa herë fjala e kryetarit të opozitës dhe e deputetëve të saj, unë përfitoj nga rasti t'u bëj tri pyetje, që, në fakt, duhet të ishin pyetje parlamentare, përfaqësuesve të maxhorancës në këtë komision të nderuar dhe përmes tyre edhe ekzekutivit shqiptar.

Pyetja e parë: unë kërkoj një shpjegim nëse është e vërtetë që javët e fundit një përfaqësues i qeverisë shqiptare ka marrë pjesë në bisedime jozyrtare për të përcaktuar kalimin e disa institucioneve të huaja arsimore private nga pronësia e një grupimi politik joshqiptar në pronësinë e një grupi tjetër politik? Në qoftë se këto bisedime janë bërë, cili është autorizimi dhe mbi çfarë baze ligjore është kryer ky transferim i pronësisë? Si janë realizuar likuiditetet dhe si janë mbrojtur interesat publike? A mundet që ekzekutivi i një vendi të kryejë bisedime private dhe transferime pronësie, ndërkohë që ky tagër u përket organeve të drejtësisë civile, të cilët mund të shpallin faliment, mund të njohin të drejta të reja, transferime pronësie dhe shitblerje?

Pyetja e dytë është një pyetje e kahershme, që i drejtohet ministres së Arsimit, por që unë nuk kam marrë përgjigje. Shkolla shqiptare është një institucion i depolitizuar dhe ligji shqiptar

ndalon shkrirjen e një veprimtarie politike me drejtimin e shkollave. Një mësues është i lirë të marrë pjesë në veprimtarinë gjegjëse politike jashtë orarit zyrtar, por një drejtues shkolle, për të garantuar paprekshmërinë dhe depolitizimin e një institucioni arsimor, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe drejtues politik rajonal, edhe drejtues shkolle, edhe shkrirës i veprimtarisë administrative në veprimtaritë e njëanshme politike të forcave respektive. E kam njoftuar prej disa muajsh ministren që shkollat e mesme në të gjithë vendin, me ndërhyrjen e njerëzve të fortë të politikës së qeverisë dhe të deputetëve, janë vendosur nën komandat e hekurta të militantëve të Partisë Socialiste, të cilët zhvillojnë aktivitet politik, informativ, segregativ dhe izolues. Kur do të hiqen këta drejtues të shkollave të politizuar? Kur do të vendosen në drejtim të shkollave të mesme të Shqipërisë mësuesit më të mirë të këtij vendi dhe sistemi arsimor të jetë në një depolitizim të pastër?

Pyetja e tretë ka të bëjë me Policinë e Shtetit, e cila u përmend në mënyrë të njëanshme. Nga njëra anë, me urdhër të ministrit të Brendshëm, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penal, ajo arreston natën qytetarë të lirë të këtij vendi, në forma të denja për diktaturat, ndërkohë e njëjta polici godet dhe gjakos gazetarë, survejon me agjentë special, këtë e them me përgjegjësi, selitë e Partisë Demokratike, ndërkohë nuk guxon të ndërhyjë në mënyrë absolute në njësitë e Partisë Socialiste në Tiranë, ku menaxherë të ardhur enkas nga zona e parë operationale e trafikut të brendshëm të kryeqytetit zhvillojnë çdo ditë të mërkure veprimtari jashtë kuadrit të transparencës legale politike. Si shpjegohet që e njëjta polici eliminon dosjet e familjarëve të politikanëve të lartë të qeverisë, përfshirë edhe të ministrit të Brendshëm, të cilët janë të skeduar, ndërkohë marrin pjesë në ndryshimin e identiteteve? Si është e mundur që nuk ka një transparencë nga Policia e Shtetit që për 5 vjet nuk është vepruar dhe është lejuar ky ndryshim identiteti?

Kam edhe një koment, i cili lidhet me nevojën që kuadri ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe i Policisë së Shtetit të ndryshojë. Ka ardhur momenti që Policia e Shtetit dhe Ministria e Punëve të Brendshme dua të vendosen në një kuadër të ri ligjor, me tagre të ndara, me synim përforcimin e pavarësisë së Policisë së Shtetit ndaj ekzekutivit, ndaj Kryeministrit dhe në mbrojtje të ligjit.

Të nderuar kolegë, dua t'ju vë në dukje se në bazë të ligjit "Për Policinë e Shtetit" drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është titullar i shtetit dhe jo i qeverisë; është ai që emëron të gjithë punonjësit e policisë, me përjashtim të 4 zëvendësrektorëve të Përgjithshëm. Praktikisht sot, që prej 5 vjetësh, nga ish-administratori i trafikut të brendshëm dhe administratori aktual

shikojmë se emërimet në polici i bën ministri dhe shpura e tij, dhe, fatkeqësisht drejtori është kthyer në një noter i ministrit. Ndërkohë, ky i fundit shquhet për ndërmarrjen e zero nismave legislative në përmirësimin e legjislacionit në fushën policore, dhe këtë e dallojmë qartë vetëm në qoftë se bëjmë një krahasim midis legjislacionit respektiv në Republikën e Shqipërisë me legjislacionin respektiv në Republikën e Kosovës, pa shkuar më tutje. Ai nuk është kujdesur në mënyrë absolute të krijojë një skuadër të luftës kundër krimit në nivel nacional, asnjë komisariat për inteligjencën në fushën e shmangies së tarifave doganore në nivel nacional. Po ashtu, ai nuk ka ndërmarrë asnjë masë kundër goditjes dhe sundimit të krimit në pjesën më të madhe të Shqipërisë.

Të nderuar deputetë, për këtë arsye kërkoj vëmendjen tuaj të posaçme për të adresuar në institucionet tuaja drejtuese politike dhe për t'i dhënë një zgjidhje të përshtatshme jo vetëm për Partinë Socialiste, por, para së gjithash, për interesat e vendit, në interes të reformimit të vërtetë të institucioneve të këtij vendi, për vendosjen e shtetit të së drejtës, për vendosjen e institucioneve ligjzbatuese për një veprimtari të saktë e të drejtë dhe, mbi të gjitha për zgjidhjen e krizës së rëndë politike, që ka mbërthyer vendin, 1 muaj para vendimit final për hapjen e negociatave me Bashkimin European.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ju lutem, kam shpërndarë deklaratën dhe kërkesën për seancë dëgjimore, ku ka ngelur që t'i pasoni këtu?! Musa, a do ta firmosësh deklaratën? Të paktën për kolegun.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëroni, zonja Mehmetaj!

Kejdi Mehmetaj – I kërkoj edhe unë falje kryetarit të AMA-s, i cili është për të dytën herë në këtë komision, por situata dhe mendoj se dhe veprimtaria e komisionit kanë qenë të tilla, që e bëjnë të pamundur zhvillimin e një seance normale për të parë rendin e ditës, sepse që në gjenezë ky komision, me procedurat që ka ndjekur, është bërë i paligjshëm. Këtë e them me bindje të plotë, sepse besoj se të gjithë ne jemi të qartë se kur jemi betuar ditën që kemi marrë detyrën tonë si deputetë, kemi thënë se detyra jonë është të jemi përfaqësues, të jemi ligjbërës, por mbi të gjitha të jemi kontrollues të punës së qeverisë.

Ndërkohë, ky komision është kthyer në mburojë e qeverisë ose kukullën e qeverisë për të bërë jo thjesht ligjet, por idetë e tyre, që shpeshherë janë edhe kriminale. E them këtë, sepse në dy

raste në këtë komision kanë kaluar me procedurë të paligjshme 2 ligje shumë të rëndësishme, ligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Një ligj, i cili, në një mbledhje të paligjshme, të panjoftuar, ka kaluar 200 nene, me një projektkalendar të bërë nga vetë maxhoranca, ishin parashikuar të trajtoheshin dhe shqyrtoheshin në së paku 5 seanca, përtej grupit punës. Në një mbledhje gjysmëorëshe, nuk e di nëse ju ka dalë koha t’i shikoni 200 nenet dhe jo më t’i shqyrtoni, pastaj t’i lexoni dhe t’i votoni.

Përsëri e njëjta procedurë e paligjshme ishte në lidhje me ndryshimet që u bënë në ligjin “Për lirimimin e frekuencave të dixhital dividitit”. Komisioni ynë ishte për dhënie për mendimi, që është jo thjesht për dhënie mendimi, por është shumë i rëndësishëm, sepse, ja ku e kemi sot kryetarin e AMA-s, ne jemi komisioni që shqyrtojmë të gjitha instancat që merren, qoftë me frekuencat qoftë me transmetimet e kështu me radhë. Ndërkohë, ne dalim me një logjikë të pakuptueshme të maxhorancës: të japë mendim një komision, që nuk ka asnjë lloj rëndësie, sepse forca e një kartoni, që për mendimin tim është po aq i paligjshëm për mënyrën se si i ka marrë mandatet, vendos të shkelë të gjitha procedurat parlamentare dhe ta kalojë ligjin në seancë plenare, pa kaluar fare në komision.

E thënë e gjithë kjo, arroganca që qeveria po tregon është kthyer dhe ulur tashmë këmbëkryq edhe në këtë komision, edhe në gjithë parlamentin, duke e kthyer këtë të fundit në një tjetër mekanizëm kontrollues, tashmë jo vetëm të jetës së qytetarëve, por edhe të jetës sonë, si përfaqësues të qytetarëve.

Ne nuk jemi këtu për t’u bërë pjesë e asnjë fasade, e asnjë *show* apo asnjë përdorimi që qeveria do t’u bëjë deputetëve të saj të maxhorancës në këtë komision. Ne jemi këtu pikërisht për të evidentuar, pikërisht për të argumentuar dhe për të dhënë alternativa ndryshe, madje këtë e themi jo vetëm ne, si deputetë të opozitës, por mendoj se të njëjtën detyrë kanë edhe kolegët e maxhorancës, por, me sa duket, e kanë harruar këtë me kohë, e kuptoj, janë të ngarkuar, janë me halle të mëdha. Në fund të fundit, të kesh dy ministra të Brendshëm të dënuar, të akuzuar, me prova e fakte, për përfshirjen në trafikun e lëndëve narkotike, pa dyshim që është një gjëmë e madhe, që mund t’i ndodhë një qeverie, e cila nuk duhet të ishte fare sot në këmbë, jo më të vinte të kërkonte që të kishte procedura normale të zhvillimit të një komisioni.

Nga ana tjetër, lidhur me rastin e gazetarit Kasmi, ku si komision, më shumë se kujt do tjetër, na takon jo ta dënojmë, por të ndërmarrim edhe hapa të mëtejshëm për të kërkuar që situata të zbardhet dhe fajtorët të mbajnë përgjegjësitë e tyre. Përsëri ka një logjikë këtu, që u shpreh edhe

nga kolegët parafolës: “Çfarë janë policët që gjuhen dhe, meqenëse policët gjuhen, këta të fundit duhet të gjuajnë qytetarët?!”

Ne kemi qenë dëshmitarë se si, edhe në rastet kur nuk është ushtruar asnjë lloj dhune ndaj policisë, janë lëshuar urdhër-arreste nga prokuroria, janë arrestuar qytetarë të ndershëm të këtij vendi, janë dhunuar brenda rajoneve policore, madje një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë burgjeve sot, pa gjetur të drejtën e tyre. Po në rastet kur qytetarët dhunohen, kush mban përgjegjësi? Askush!

Më thoni një rast të vetëm të një oficeri policie, të një drejtuesi të lartë të shtetit, që ka mbajtur një përgjegjësi qoftë edhe të vogël, kur është dhunuar, jo gazetari, se është edhe më e rëndë, por qytetari i këtij vendi. Unë nuk di asnjë rast të tillë, përkundrazi, di raste të panumërta, që shkojnë çdo ditë në prokurori; raste të panumërta që janë rajoneve të policisë, që janë në paraburgim, që janë në procese gjyqësore pse kanë dalë të lirë, të qetë në rrugë dhe janë mbledhur për të protestuar për të drejtat e tyre. Këtu fillon baza e një shteti, që është demokratik. Por unë e thashë, në këtë hall të madh që i ka rënë kësaj qeverie, e cila po përpiqet me të gjitha format të mbajë një karrige apo disa karrige, që nuk u kanë takuar as kur u emëruan në to, e kuptoj që nuk mund të presim të ketë ndjeshmëri apo të sillen siç u ka hije deputetëve të zgjedhur nga qytetarët.

Kështu që, për t’jua sjellë edhe një herë në vëmendje, unë gjithmonë besoj te reflektimi dhe te përgjegjshmëria juaj, si deputetë, ta vazhdojmë këtë seancë të komisionit duke dënuar dhunën ndaj gazetarit, por duke dënuar ndërkohë dhunën që ushtron policia, prokuroria dhe të gjitha institucionet e këtij vendi ndaj qytetarëve, të dënojmë më tej edhe rastet flagrante që ka kjo qeveri, të lidhura me krimin dhe drogën, dhe pastaj të ulemi të diskutojmë edhe nenet, edhe ligjet, të kthejmë mbrapsht edhe ato që keni bërë gabim, me qëllim e me vetëdashje, për të vazhduar në procedurat normale.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, Kejdi!

Fjalën e kanë kërkuar zoti Balliu, zonja Malaj dhe zoti Rrokaj.

Klevis Balliu – E shoh se kolegët deputetë të Partisë Socialiste janë shumë të qetë dhe nuk po bëjnë asnjë debat, se është për mbrojtur një gazetar. Të ishte për të mbrojtur Elvis Roshin, do t’u çirrej zëri, apo për Saimir Tahirin, do të kërcenin sipër tavolinës, do të çoheshin, do të bojkotonin. Kur vjen puna për të mbrojtur Mark Frrokun, i gjithë Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, bënte 18 deklarata në ditë, ndërsa për të mbrojtur një gazetar, asnjë.

Është normale, unë e kuptoj, sepse është gjenetike e Partisë Socialiste të ketë alergji nga gazetarët e lirë; janë mësuar me gazetarët e ERTV-së.

Kur vjen puna për të folur për qytetarin në Korçë, i cili vdiq brenda rajonit të policisë së burgut, në duart e policisë tuaj, asnjëri nuk flet.

Qenka gërvishtur Saimir Tahiri te protesta e “21 janarit”, ku thirrët banditë e kriminelë, nuk latë njeri, me ata banditë e kriminelë që qeverisni sot, ende vazhdoni: “Pse na e gërvishtët Saimirin”, pavarësisht se ky njeri kanabizoi një vend të tërë; kriminalizoi një shoqëri të tërë; vazhdon mbrojtja për Saimirin?!

Kur vjen puna për të mbrojtur qytetarin tjetër në Shkodër, i cili nga dhuna që pësoi nga policia vrau veten sapo doli nga aty, nuk thoni asnjë fjalë për të!

Kur vjen puna për të mbrojtur Robert Ndrenikën, artistët, jo, ju do të shembni Teatrën Kombëtar, nuk i mbron ato?! Të vetmit njerëz që mbron ju, madje ngrijani vetes si pyetje: “Si përfunduam deri këtu?”, duke mbrojtur çdo narkotrafikant që shkel në Shqipëri: Mark Frroku, Elvis Roshi, Arben Ndoka, Armando Prenga, Saimir Tahiri, Agron Xhafaj?!

Si përfunduat deri këtu? Kush ju solli deri në këtë derexhe? Një person, Edi Rama, i cili e ka drogën kriter dhe frymëzim!

Së fundi, se nuk dua të zgjatem, pasi e shoh mosinteresimin për dhunën ndaj gazetarëve dhe nuk pres asgjë më shumë dhe asgjë më pak nga një parti, e cila sot është kthyer në parti memecësh: asnjëri nuk flet, flasin me shenja, flasin me mesazhe; del ndonjë ministër nga ku ka shkuar me pushime në Francë, në Itali, në Gjermani, por nuk ka asnjë ministër apo deputet që të dalë dhe të thotë: “Po, mor zotëri, keni të drejtë, dhuna është e dënueshme!”

Pse të mos e dënojmë ne policin, që goditi gazetarin? Kishte 30 protestues përpara, por shkoi dhe piketoi pikërisht gazetarin?! Pse? Pse nuk del njëri të thotë: po, mor, gabim është!

Unë nuk mendoj se e ka dhënë, më falni që po e përmend, Fideli urdhrin që të godasë gazetarin, por e bëri polici?! Por mund ta dënosh. Polici duhet të jetë më i kontrolluar, se atë detyrë ka.

E vërtetë është ajo se nuk duhen sulmuar policët, pasi paguhet me rroga qesharake për të bërë një punë të jashtëzakonshme; rroga, të cilat i jep qeveria juaj! Prandaj ne nuk i sollëm njerëzit tanë me çadra, me hekura, me leva, me pistoleta, me bomba dore, sepse e keni në *Youtube* atë protestuesin tuaj që mban bombë në dorë, por i sollëm me pankarta, me bluza të bardha, që të mos

godasin policinë. Prandaj u tërhoqën ato, prandaj unë besoj dhe shpresoj, por këtu ka mbetur vetëm shpresa në Zot. Hajde se inshallah po bëhet dhe nuk flet njeri.

Jo, zotëri! Do të bëhet, sepse ne do ta luftojmë krimin dhe korrupsionin dhe do të hapen negociatat. Jo, ne kemi mbetur në mëshirë të fatit. Do Zoti, të hapen negociatat! A keni dëgjuar ndonjë kryeministër të thotë: “Do Zoti të hapen negociatat”? Ky e thotë. Nuk ka nevojë, të lutesh. Bëje punën dhe të hapen negociatat.

Fatmir Xhafaj duhet të japë dorëheqjen, sepse e ka të vëllain në burg dhe ai vetë nuk e kalon dot vetëingun që po ua bën policëve. A ka gjë më logjike ? Çfarë kundërgumenti keni ju për këtë? Ky u bën vetëing policëve dhe vetë nuk e kalon dot.

Fatmir Xhafaj duhet të japë dorëheqjen, se i ka vdekur një qytetar në burg! Apo nuk ka problem, se nuk është deputet, nuk është ministër ai.

Larg qoftë, mos na gërvishtet Saimir Tahiri! Larg qoftë! Në arrest shtëpie ishte Saimir Tahiri dhe ju u çatë duke marrë prokurorinë që ta shpëtonit atë. Bëtë denoncime dhe arritët të bënit karagjozllëqe. Opozita paska bërë në 630 kg drogë! Edhe po ta kishte bërë, juve ju takon të na arrestoni, zotëri. A punoni ju? Ju po qeverisni prej 5 vjetësh dhe po silleni sikur jeni në opozitë.

E tha mirë zonja Duka. Ku është parë kjo? Tubime, tubime dhe tubime. Ky Kryeministër luan 2 orë basketboll, 2 orë bën boçet me baltë në zyrë, 2 orë bën sikur pikturon dhe 6 orë rri në televizor. Kur punon ky zotëri? Çfarë pune bën? Na thoni një gjë sot! Keni një vit (250 ditë), që keni ardhur në punë, që i keni fituar zgjedhjet, çfarë pune keni bërë, përveçse keni mbrojtur Saimir Tahirin? Asgjë tjetër. U munduat të kapni çdo institucion shtetëror, kapët drejtësinë dhe s’bëtë asnjë gjë tjetër.

Doni të hapni negociatat! Po çfarë i dini europianët ju, budallenj? Ju kujtoni se meqë i besoni vetë ato që thoni te RTV-ja, do t’i besojë edhe Europa? Jo, në PS ka njerëz që kanë qenë gazetarë.

Ka që në vitin 2002 debati për Teatrin. U çuan 20 deputetë socialistë dhe firmosën kundër qeverisë socialiste, ndërsa sot nuk pipëtin njeri në PS, sepse aty nuk drejtojnë as politikanët, as gazetarët, as artistët, por drejtojnë banditët. Bandat ju kanë kapur peng, sepse kanë kapur Edi Ramën, i cili ka të vëllain të përfshirë në dosjen e drogës së Xibrakës. Këtë nuk e them vetëm unë, por e thonë një seri njerëzish, e thotë edhe faktori ndërkombëtar. Për këto çështje shkoni dhe kërkojini llogari atij!

Zotëri, po na detyroni të mbrojmë narkotrafikantët. Nuk themi dot një fjalë për të mbrojtur një gazetar apo një artist. Shkuat u bëtë veting edhe mjekëve. U bëri veting mjekëve ky, që çdo 6 muaj e shpëtonte mjeku nga overdoza. Këtu keni arritur ju. Unë e kuptoj që jeni fare të qetë dhe nuk ju intereson fare.

Edhe protestën tonë mund ta quani si të doni, por po të ishte ajo protestë ashtu siç e mendoni ju, nuk shkonte i gjithë kabineti te vrima e miut dhe ato kamerat që paguhen me miliardat e drogës, që i mbani çdo ditë para fytyrës, ditën e protestës, nuk po i gjenin dot në vrimën e miut, ku ishin futur.

Po të kishte qenë ashtu, nuk futeshin në atë vrimë ata, por rrinin në institucion. Si të doni, si ta mendoni, por ora po vjen. Vendoseni vetë se në cilin krah duhet të jeni, në krah të shqiptarëve apo në krah të bandave!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Fjalën e ka Nora!

Më pas, e kanë fjalën Shezaiu dhe Milva!

Nora Malaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht, edhe unë do t'i kërkoja ndjesë zotit Cala për këtë bashkëbisedim që po bëj, por mendoj se askush nga ne mund të bëjë indiferentin dhe të thotë se jemi në një situatë shumë të qetë dhe komisioni mund të vazhdojë punën në mënyrë shumë normale, në një kohë, kur po përballemi me disa momente shumë kritike, që lidhen jo vetëm me komisionin, por në radhë të parë, lidhen me identitetin, statusin dhe pozicionin e vendit tonë.

Nëse nënshkruam një rezolutë të përbashkët dhe unë besoj se edhe kolegët e pozitës do ta bënin këtë gjë, nuk e bëjmë për të treguar se ne jemi thjesht pjesa propagandistike për të mbështetur gazetarin dhe fjalën e lirë. Ne e nënshkruam për të kuptuar se në një vend europian, i cili do të integrohet dhe është pjesë e Konventës për të Drejtat e Njeriut, nuk mund të mos zbatohen të drejtat e njeriut. Natyrisht, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik e ka detyrë ligjore që ta trajtojë, ta mbështesë dhe jo vetëm ta llojë fort, por duhet të kuptohet se mbas kësaj nuk duhet të ketë më asnjë lloj dhune ndaj çdo gazetari, i cili jo vetëm është zëdhënës i fjalës së lirë, në terren ose jo, që ka një identitet të shfaqur, por është shumë e rëndësishme të mbrohet, sepse atë nuk e mbron vetëm ligji, por e mbron edhe e drejta.

Edhe problematika që do të trajtojmë sot, lidhet pikërisht me të drejtat e dhënies së transmetimit dhe me nevojën që kemi për t'u informuar drejt, për të marrë çdo subjekt të drejtën e tij dhe për t'u motivuar edhe me pagën e tij.

E dyta, unë mendoj se jemi në një situatë, kur jo më larg se dje disa medie sociale paraqitën një rast të rëndë të një fëmije, i cili ishte në një nga pozicionet më të tmerrshme, ku një pedofil po luante në mënyrën më të shëmtuar duke kryer një raport seksual me të. Fëmija ishte vetëm 10 vjeç. Ngjarja ka ndodhur në qytetin e Kavajës. Nga mediet u tha, se i rrituri është me probleme psikike etj.

Pyetja që shtrohet është: ne, si Komision për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, 2 ditë përpara 1 Qershorit, kur ne flasim për të drejtat e fëmijëve dhe themi se duhet t'i mbrojmë ata, ku jemi sot? Çfarë po ndodh sot? Cila është situata që po shfaqet dhe çfarë po ndodh me ruajtjen edhe të kategorisë së atyre fëmijëve që mund të mos kenë prindër dhe mund të jenë situata të vështira, por shoqëria është aq indiferente dhe kaosi është aq i madh sa që shpeshherë të duket, sikur jemi në drejtime të paditura dhe nuk e dimë se kush ka detyrimin dhe se çfarë detyrimi ka?

Në momentin kur na vihet një informacion i tillë nga rrjetet sociale, a duhet që Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ta marrë si prioritet dhe ta diskutojë këtë çështje?

A duhet që ne të pyesim: çfarë po ndodh? Si do t'i zgjidhim këto situata?

Në fund të ditës, kur do të diskutojmë për probleme shumë të rëndësishme siç janë ligjet që rregullojnë jetën tonë, po situata të tilla, të cilat nuk janë sporadike, por na shfaqen çdo ditë? Çdo ditë na del një informacion i ri dhe një situatë e re, që na bën të ndihemi si në udhëkryq. Çfarë po ndodh me ne? Si do t'i zgjidhim këto probleme?

E treta, mendoj se ka ardhur momenti, kur përtej fazës së dialogimit, të qëndrojmë dhe të këmbëngulim fort në atë që quhet shtet ligjor dhe i së drejtës. Shteti ligjor dhe i së drejtës fillon që nga komunikimi dhe bashkëbisedimi ynë, vijon me interpretimin e informacionit që jep media, për të vazhduar tek çdo qytetar, i cili mund të jetë në paraburgim apo në burgim, por duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë, që të mos ndodhin rastet që po ndodhin sot.

E katërta, jemi përpara një situatë që shpeshherë duket sikur është pa kokë dhe pa këmbë. Ajo që unë ndjej, si deputete, por edhe si përfaqësuese e pjesës intelektuale, është pamundësia për të dialoguar në seancat parlamentare dhe pamundësia për të thënë mendimin tënd edhe kur je në opozitë.

Opozitar nuk do të thotë të mos flasësh, të heshtësh dhe të mos japësh kontribut. Kjo gjë është kthyer në makth dhe shqetësim. Kjo tregon se gjërat nuk shkojnë ashtu siç duhet. Komisioni ynë lidhet jo vetëm me edukimin dhe mediet, por edhe me liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat prekin dy fusha shumë të rëndësishme: fushën e edukimit të fëmijëve dhe atë të standardit dhe cilësisë së jetës. Për këtë arsye i bashkohem asaj deklarate të përbashkët dhe për këtë arsye them që duhet të reflektojmë të gjithë përtej interesave politike, sepse edhe interesi politik është interesi i të drejtës së njeriut, pasi liria ime mbaron atje ku fillon liria jote. Nëse ne do të japim shembullin e mirë për të qenë bashkë për kauza të përbashkëta, jam e bindur që zgjidhja e problemeve do të jetë në tavolinë.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Fjalën e ka zonja Milva.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ajo që dua të ndaj me ju lidhet me disa çështje, që janë të rëndësishme për t'u diskutuar.

Së pari, nuk e di nëse në datën 21 maj, në *e-mail*-in ose *whats app*-in tuaj, ju erdhi një pyetësor nga SCPA-ja, një organizatë jofitimprurëse në Amerikë, e cila bënte një sondazh për pjesëmarrjen tonë në protestë. Në fund të vrojtimin në gazetë doli një artikull që fliste për një numër protestuesish që do të merrnin pjesë në protestë. Nga hulumtimi që SCPA-ja bëri doli se në protestë ishin rreth 1\3-a e atyre që deklaroheshin të përlllogaritur nga SCPA-ja. Unë besoj se këto argumente hedhin dritë për numrin e protestuesve, por tregojnë gjithashtu se juve ju duhet një kauzë, e cila mund të lidhet shumë mirë me nevojën që mund të ketë popullsia për një përfaqësim më të mirë. Kjo tregoi se edhe pse u angazhuan për të rritur pjesëmarrjen popullore, njerëzit prapë nuk dolën në protestë.

Për sa i përket çështjes së dhunimit të gazetarit, në fakt, unë nuk besoj se opozita e ka shumë herë shkopin e së vërtetës. Ju keni nevojë që gjërat që thoni, t'i konfrontoni me mënyrën si sillen ligjet apo si veprohet në Shqipëri. Në disa televizione shqiptare, siç është Report Tv, Klani e të tjerë, ne kemi parë filmime ku ky gazetar një herë është qëlluar me gurë, një herë është qëlluar me shkop mbi syzet që kishte në kokë dhe disa herë është filmuar duke shkukur mjetet që shërbenin për mbrojtjen e godinës së Ministrisë së Brendshme. Në fakt, gazetari nuk ishte në detyrë, sepse nuk e kishte *beixhin* e gazetarit. Unë e respektoj profesionin, është fat i madh që sot kemi një media që është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si protestues nuk duhet të dhunohet, por ju e patë shumë mirë ...

Albana Vokshi – Dhuna ishte e targetuar.

Milva Ekonomi – Nuk ishte e targetuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund të mos bëj pyetje-përgjigje me ju?

Albana Vokshi – Mos i manipuloni.

Milva Ekonomi – Nuk po i manipuloj, por po ju sjell vëmendjen që kanë parë televizionet për këtë rast.

Albana Vokshi – Cili?

Milva Ekonomi – Të gjitha televizionet.

Mos mbani shkopin e së vërtetës, sepse duhet të keni më shumë informacion për të konkluduar për rastin.

Natyrisht që dhuna e ushtruar në një protestë është e dënueshme, por siç pësoi dhunë një njeri i zakonshëm, që në këtë rast kishte profesionin e gazetarit, Blendi Kasmi, po ashtu pësuan dhunë edhe 12 oficerë policie, të cilët u trajtuan nga mjekët shqiptarë në Spitalin Universitar të Traumës.

Një tjetër gjë e rëndësishme që dua të ndaj me ju lidhet me lirinë e medieve në Shqipëri. Ne kemi parë raporte, që na vijnë nga “Reporterët pa kufij”, por edhe nga monitorimi i përvitshëm i AMA-s, ku thuhet që liria e mediave në Shqipëri është e konsiderueshme. Këtë gjë e kanë thënë jo vetëm këto raporte, por edhe raporte të tjera nga Këshilli i Europës, si dhe progres-raporti i Bashkimit European.

Sot në Shqipëri funksionojnë rreth 300 portale. AKEP-i të jep liri maksimale për të hapur portalin tënd. Në rast se ka një rast të bllokimit të portalit, me siguri ka diçka që nuk shkon ligjërisht. Përpara se të dalim me konkluzione, është mirë të dëgjojmë palët dhe të kuptojmë çfarë situatash kanë ndodhur në AKEP, që kanë marrë këtë vendim.

Për sa u takon çështjeve që shtroi Kejdi lidhur me disa ligje në komision, së pari, dua t’ju falenderoj për kontributin e dhënë për ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Për këtë ligj ne punuam me një plan pune, që ndahej në tri pjesë të rëndësishme:

Pjesa e parë kishte të bënte me dëgjesat publike. Ne kërkuam të na vihej në dispozicion informacioni me shkrim për çdo dëgjesë që bëme. Mos harroni se komisioni përpunoi rreth 238 komente për ligjin. Gjithashtu, secili nga anëtarët e komisionit solli me shkrim në sekretari

opinionin e vet për ligjin. Të gjitha këto u morën në konsideratë nga grupi i vogël i punës, taskforce brenda në komision, që punoi për ligjin. Të gjitha këto detyra u kryen.

Unë besoj se në fund të këtij procesi, komisioni, pavarësisht nga ngjarjet politike të ditëve, duhet të ndihet krenar për kontributin e dhënë në përgatitjen e ligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Të gjithë arkeologët, ata që erdhën dhe ata që u thirrën, kanë sjellë komente dhe pjesa më e madhe e tyre janë marrë në konsideratë.

Përveç kësaj, unë besoj se duhet të kemi në konsideratë edhe përkushtimin e grupit të punës, sepse përballë kishte disa ekspertë të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, si edhe studion private që ky fondacion kishte marrë në ndihmë për hartimin e ligjit.

Shpesh në këtë komision ne nuk zbatojmë rendin e ditës, sepse diskutohen çështje politike, që nuk i përkasin punës së komisionit, të cilat duhet të kenë një platformë për t’u shfaqur. Është e drejta e opozitës t’i bëjë këto gjëra, por kemi edhe çështje të tjera, që lidhen me shqetësimet e qytetarëve.

Ne duhet të falenderojmë kryetaren dhe sekretarinë e këtij komisioni, që çështje të ndryshme të qytetarëve i kanë marrë në konsideratë. Ne jemi një nga ato komisione që na kanë lavdëruar për dëgjesat e mëdha publike që kemi bërë për rastet kur janë shfaqur shqetësime. Unë besoj se e gjithë kjo duhet të kthehet në një instrument që të kuptojmë se jeta opozitare është e bukur kur çon përpara diçka, që i shërben qytetarëve. Këtë jemi përpjekur të bëjmë ne, pozita në komision, por një gjë duhet të jetë e vërtetë, ne të gjithë duhet më parë të këshillohemi me ligjin dhe me rregullin. Këtë gjë të mundohemi ta bëjmë vazhdimisht.

Për sa i përket një çështjeje tjetër që shtroi zonja Duka, ajo që pozita ka dashur të bëjë lidhet me faktin që ne socialistët mendojmë se Shqipëria ka nevojë për shtet, punë dhe mirëqenie. Pasi e fituam fushatën zgjedhore me këtë moto dhe erdhëm në pushtet me këtë numër të votave që kemi, një nga gjërat e rëndësishme që po përpiqet të bëjë qeveria është të kërkojë matjen e performancës së saj. Matjen e performancës e bën nëpërmjet bashkëqeverisjes. Ju e dini se ka një platformë, bashkëqeverisja me njerëzit, ku çdo ministër, çdo zëvendësministër që është në detyrë politike merr mendimin për detyrën e tij, jo nga ajo pjesë e zgjedhësve që janë pozitarë, por edhe prej atyre që janë opozitarë lidhur me vështirësitë që ata kanë ndeshur në të ofruarit e shërbimeve të administratës ndaj qytetarëve. Unë besoj se ju e keni parë që në këto tubime, që nuk janë politike, por janë teknike, në përgjithësi zgjidhen edhe çështjet e opozitarëve, jo vetëm

të pozitarëve. Kjo vjen për arsye se administrata jonë publike, në fakt në gjithë këta vjet dëshmoi se ka qenë e paqartë, në mjegullnajë për të punuar. Një nga gjërat që po bëhet është që administrata publike t'i japë përgjigje nevojës që ka qytetari i zakonshëm për ta ndjerë shtetin që është në shërbimin dhe në dobinë e tij. Unë mendoj se këto janë gjërat e rëndësishme, por të mos harrojmë edhe një gjë, që Shqipërisë iu dha nga Komisioni European rekomandimi pa kushte për t'ju hapur negociatat. Është hera e parë që Shqipëria merr rekomandimin pa kushte.

Albana Vokshi - Nuk ka rëndësi. 28 ditë kohë keni, do t'i shikojmë edhe kushtet.

Milva Ekonomi - Rekomandimi pa kushte që mori Shqipëria nuk është një gjë e zakonshme, sepse kjo u lidh me performancën e disa detyrave. Performanca më e rëndësishme ishte shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi. Kjo e fundit është një gjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...e nxorëm me ato gjykata që janë aty, që veprojnë prej 3 vjetësh. Prandaj ka nevojë të vendoset dhe të funksionojë vetingu në drejtësinë shqiptare, që të kuptohet shumë mirë se detyra e një prokurori, e një gjyqtari është një detyrë publike dhe i shërben funksionimit më të mirë të ligjeve që ka vendosur Republika e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse jemi në këto kushte të suksesit, të performancës, të hapjes së procesit, nuk është vetëm qeveria shqiptare që i ka vënë në dukje, por i kanë vënë edhe të tjerë njerëz që vijnë nga BE-ja, nga Këshilli i Europës, ju i keni dëgjuar, sepse kanë qenë, kanë ardhur këtu, presidenti Tusk dhe të tjerë parlamentarë nga BE-ja. Besoj se kjo është një e vërtetë tjetër, një e vërtetë përtej asaj që diskutojmë ne. Shqipëria ka bërë progres në rekomandimet që ata kanë dhënë dhe në prioritetet që kanë dhënë për të qenë një vend që i hapet porta e asociimit. Unë nuk dua ta besoj se ju doni të bëheni pengesë për këtë gjë. Të ngresh tani në këtë situatë të tilla skena, nuk është aq kombëtare.

Do t'ju lutesha shumë që të mos i bëni këto gjëra...

Albana Vokshi – Saimirin e kishit koordinatorin e mbledhjes së parave të drogës për financimin e fushatave.

Milva Ekonomi - Shikoni se si jeni duke u sjellë vetë dhe pastaj merrni një vendim për qëndrimin që duhet të mbani. Bojkoti nuk është zgjidhje e rëndësishme.

Albana Vokshi - Keni bojkotuar ju, e vetmja maxhorancë. Kjo është marrëzi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Edhe ne kemi qenë në tavolinë, por ajo që kemi dashur gjithmonë është që kjo pjesë e komisionit të ketë të drejtën e fjalës në mikrofon dhe të ketë të drejtën të ndiqet sipas rendit të ditës mbledhja, të cilën kemi marrë përsipër të zhvillojmë.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Unë nuk e di nëse ju është mohuar ndonjëherë fjala. Folët ju, kolegu Ylli, të gjithë folët. Flisni sa minuta të doni dhe për çfarë të doni, vetëm ju lutem, mos bojkotoni se është turp i madh!

Unë nuk e di nëse ajo shoqata që përmende ti, ka monopolin e vërtetësisë së numrave...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Që të pyetet një OJF sesa a protestues janë, unë nuk kam dëgjuar ndonjëherë. Është hera e parë që policia ka refuzuar të japë një numër të përafërt të protestuesve. Por për çdo lëvizje, çdo raportim, çdo informacion nga degët tona dhe për të gjithë qytetarët që kemi vënë re në Tiranë, janë numra ose të përafërt ose shumë më tepër sesa ato të 27 janarit. Kjo është ajo që ju bëri juve të humbisni qetësinë dhe të urdhëronit të targetonit edhe gazetarët, kryeredaktorin e gazetës “Rilindja Demokratike” që po raportonin në kohë reale.

Ja ku e keni!

Është për turpin tuaj që nuk reaguat. *Reporters Without Borders* raportuan të partë. Është organizata më e madhe për lirinë e shtypit dhe kurrë nuk del në një prononcim pa verifikuar të gjitha faktet edhe ato nga televizionet që ju përmendët, por edhe nga burime të tjera, sepse një organizatë prestigjioze si *Reporters Without Borders* nuk do të mund të humbte kredibilitetin për një prononcim, pavarësisht shantazheve që i bëri Fuga me të gjithë zyrën e shtypit, që dërgonin mesazhe në *twitter*.

Gjithsesi, unë isha vetë e pranishme, e shoqërova Bledin me ambulancë në spital, i bëra edhe foto, sepse ju jeni nga ata që thonë: “U lye me bojë”, humbni provat, i manipuloni ato, kështu siç po mundoheni të bëni edhe tani. Plagën ju siguroj se e kishte shumë të madhe dhe shumë të thellë; nuk është shkaktuar me shkop gome, por me shkop hekuri. Kjo është e turpshme, të targetohet një gazetar me *bexh*-in ose pa të, të vijë polici nga dy rreshta më mbrapa dhe të targetojë vetëm kryeredaktorin e “Rilindjes demokratike” kjo është e dënueshme, prandaj solidarizohuni! Musai i pari, pasi e ka kryer këtë profesion, juve të tjerët, sepse jeni në një komision për çështjet e medias. Solidarizohuni kundër dhunës. Nuk mund ta mbani pushtetin me këtë lloj dhune. Shprehuni, firmosni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja ku e ke deklaratën, Fidel! Firmose deklaratën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cila është dhunë e njëanshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prit, se do të ta tregoj. Kam vajtur unë, Klevisi... Ti nuk shkove ta vizitoje Bledin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kam shkuar unë, Klevisi dhe zoti Spahia, që është mjek.

Kemi vajtur të tre dhe kemi vizituar të gjithë policët, që erdhën më pas. Nuk dua ta paragjykoj fare atë çfarë pashë. Vajta dhe i pyeta një më një. Kam shkuar te shtrati dhe karrigia e gjithsecilit, bashkë me kolegët e mi. Për fatin tonë të mirë, për fatin e tyre të mirë dhe për fatin tuaj të mirë, asnjëri prej tyre nuk kishte ndonjë plagë. Asnjë gërvishtje. Nuk kishin shenja gjaku. Vetëm pasi folëm edhe me mjekun e u siguroam se ishin shumë mirë, pasi folëm edhe me ta, u larguam. Në rregull? E kemi bërë detyrën tonë. Shihe si e keni kryeredaktorin! Të gjakosur. Do të vijë të hënën edhe t'ju shpjegojë, që nëse plaga do të ishte marrë pak më përpara, ai do të kishte humbur sytë, ndërsa pak më pas do të kish humbur dhe mendjen. Distancohuni nga kjo dhunë!

Njëzet e tetë ditë përpara...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka nisur *countdown*-i. Njëzet e tetë ditë para se të merret vendimi, distancohuni që nuk jeni palë me krimin! Distancohuni, po ju ftoj: distancohuni nga dhuna! Firmoseni deklaratën! Distancohuni nga krimi! Mos festoni kur lirohet Saimir Tahiri, sepse ai është rrëzimi i shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Shezai.

Shezai Rrokaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi të dëgjohem, për të thënë dy fjalë? Faleminderit!

Unë mendoj se ky është një moment shumë i rëndësishëm për këtë komision: bashkimi drejt mbështetjes së deklaratës për mbrojtjen e gazetarëve. Prokuroria, organet e zbatimit të ligjit mund t'i thonë të gjitha aspektet në lidhje me faktin e sa e ka zbatuar ai detyrën e gazetarit e të tjera. Natyrisht, nga pikëpamja humane, ne deputetët e opozitës këtu, nuk jemi më pak të ndjeshëm ndaj policëve të dëmtuar, sepse ata janë bij të këtij vendi dhe ushtrojnë detyrën, por ne jemi Komision i Medies dhe nuk na nderon fakti i mosmbështetjes së deklaratës. Pse? Sepse, para së

gjithash, demokracia lidhet me fjalën e lirë, dhe në këtë rast, ai gazetar është simbol i fjalës së lirë dhe mbrojtje e statusit të gazetarit.

Kësisoj, në të gjitha aspektet, mbrojtja e gazetarit do t'i bënte shumë mirë vetë vendit tonë, vetë kësaj qeverisjeje, bashkimi me atë formulim, ku reporterët pa kufi janë shprehur në mbrojtje të gazetarit. E para.

E dyta: gjithë këto kohë kemi dëgjuar interpretime të protestës. Kryeministri është marrë me protestën, duke e quajtur “Babale – protestë”, “antikombëtare”, “tradhti kombëtare”. Protesta zhvillohen në të gjitha vendet. Unë po ju them se, sa më shumë që të protestohet në Shqipëri, aq më shpejt hapet drita jeshile për ta integruar Shqipërinë, sepse është shenjë demokracie. Jemi ndër të vetmet vende që paragjykojmë protestat. Nuk ka rëndësi sa marrin pjesë në një protestë, por ka rëndësi mesazhi që jep ajo protestë. Dhe mesazhet e asaj proteste kanë të bëjnë me ato kushte të parealizuar që ka Shqipëria, kushte të vëna nga ndërkombëtarët. Pra, protesta dhe opozita kanë qenë në sintoni me vetë ato që Bashkimi European pret prej Shqipërisë, që janë: lufta kundër korrupsionit; lufta kundër drogës; çështjet që lidhen me administratën publike; paanshmërinë e gjyqësorit; çështjen e të drejtave të njeriut; çështjen e dialogut politik.

Çfarë ka të keqe në këtë mesazh të protestës, e cila penguaka çeljen e negociatave? Përkundrazi, unë mendoj se angazhimi i opozitës për të shprehur fjalën e saj, për të dhënë mesazhet e saj, në zbatim po të këtyre kushteve të vëna nga Bashkimi European, është ndihmesa më e madhe që po i bëhet kësaj qeverie dhe gjithë popullit shqiptar, sigurisht, për çeljen e negociatave. Kështu duhet interpretuar, dhe jo të ashtuquajturat llogaridhënie, të cilat me të vërtetë janë kthyer në skena teatrale. Thoshte një eksponent i lartë i qeverisjes: “Kam ardhur këtu, për të më vënë ju mua me shpatulla për muri!”.

Po a thuhet këto në shekullin XXI? Çfarë janë këto mesazhe? “Xhaxha, kam ardhur që ti të kuptosh se përse mësuesi i kërkon nxënësit ID-në e kartës së identitetit”. Ndërkohë xhaxhai s’ka lidhje fare me atë nxënësin, por mund t’i thuhet se përse e ka pensionin të ulët, përse s’ka rrugë, pse s’ka furgonë, pse s’ka një mjek në atë zonë, unë e njoh mirë atë zonë, pse s’ka një mjek, pse s’ka një infermier, pse s’ka ujë, pse po ikin njerëzit, pse rruga nuk po bëhet?

Kjo është llogaridhënia. Nëse doni ta bëjmë llogaridhënien, hajt ta bëjmë! E dimë se nuk do të bënim mrekullira as ne, por jo pudrosje ekranesh, thjesht për t’ia hedhur Europës. Kujtojmë se po ia hedhim Europës, duke u kamufluar, që të mos na shikojë? Në të vërtetë, ne po ia hedhim vetes. Po ia hedhim vetes. Fshatrat janë pa ujë, fshatrat s’kanë rrugë, fshatrat s’kanë mjekë, s’kanë

furgonë për të mbledhur nxënësit, s'kanë punë, po ikin, nuk ka zhvillim të qëndrueshëm për të zëvendësuar plantacionet e kanabisit me plantacione të tjera të bimëve të dobishme. Kjo është llogaridhënia. Unë kështu e kuptoj.

Po çfarë bëjmë? Ne, këtu në Shqipëri, që prej njëzet e shtatë vjetësh jetojmë me dy të vërteta: një të vërtetë që e jep maxhoranca, një të vërtetë tjetër që e jep opozita. Një dramaturg ka shkruar një vepër me titullin: “E vërteta sipas secilit”. Secili ka të vërtetën e tij, por ka një të vërtetë që është mbi të vërtetat, dhe kjo është gjendja e shqiptarëve. Pse po ikin shqiptarët prej Shqipërisë? Po ikin thjesht e vetëm pse kërkojnë një jetë më të mirë? Sigurisht. Po ku jemi ne? Çfarë po u ofrojmë? Cilat janë vendet e punës? Cilat janë perspektivat e zhvillimit? Si qëndron problemi i varfërisë? Si qëndrojnë problemet e distancës që po rritet gjithnjë e më shumë mes një kaste dhe popullit të thjeshtë.

Këto janë problemet që duan llogaridhënie. Duhet parë realitetet në sy, si nga opozita ashtu edhe nga maxhoranca. Këto janë realitete, dhe jo ato realitete që dikur do ta vënë notën 6. E dini çfarë ka ndodhur me notën 6? Jua them unë: dy vjetët e fundit është rritur fiktiviteti 8 %, që do të thotë se 8 % e nxënësve, sipas statistikave të ministrisë, mbarojnë maturën shtetërore me notën mbi 6. Është rritur mbi 6. Në 2015-ën, kur s'ishte nota 6, ishte 16 % e nxënësve nën notën 6, ndërsa në vitin 2016 e 2017, 4 % çdo vit, pra 8 %. Ky është fiktiviteti, siç është fiktiviteti pse në zona të Shqipërisë, nuk gjenden faktorët që ndikojnë në arsyen përse jemi vendi i fundit në Europë në lexim dhe matematikë.

Sa qëndron braktisja e shkollës në këto zona? Ka shifra alarmante, që po na i japin të huajt, jo se po i nxjerrin ne. Unë nuk përmend kurrë shifra personale, por përmend vetëm shifra zyrtare, të marra ose nga ministria, ose nga ndërkombëtarët.

Pra, ka ca problematika që na nderojnë më shumë dhe na bëjnë më të vetëdijshëm për një qeverisje të shëndoshë. Por çfarë po ndodh?

Këtu nuk po qeveriset. E vetmja qeverisje që po bën maxhoranca është të merret me opozitën. Shqiptarët po ikin dhe maxhoranca po merret me opozitën.

Po çfarë pune ka maxhoranca me opozitën? Asnjë punë. Maxhoranca e ka punën me qytetarët, kurse opozita e ka punën me maxhorancën, sepse ajo qeveris. Ne do të flasim kundër. Ç'punë keni ju që na tregoni si duhet të jemi ne si opozitë? E ndritët punën me qytetarët, me Shqipërinë, me pensionistët dhe do të merreni vetëm me ne si opozitë! Na lini ne të bëjmë punën

tonë! Merruni me qeverisjen, me qytetarët, në mënyrë që të kurseni edhe disa fjalë më shumë që do të kisha dëshirë t'i thosha, por po respektoj edhe kolegët e tjerë!

Faleminderit!

Valentina Duka - Dua të sqaroj vetëm konceptin e dëgjesave me kolegen Milva.

Dëgjesat publike dhe institucioni i portalit nuk janë institucione të sistemeve demokratike, por janë institucione të sistemeve moniste, janë shumë pranë modelit enverian, ku Enveri priste letra nga populli dhe priste koka intelektualësh dhe burokratësh, kurse ju prisni koka drejtorësh, koka ministrash nesër. Jo, këto nuk janë institucione me të cilët funksionon një shtet demokratik.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Urdhëroni!

Edmond Spaho - Meqë shumë gjëra i ngriti zoti Rrokaj, desha vetëm t'u përgjigjesha dy çështjeve që ngriti zonja Milva, të cilën e njoh prej vitesh, por politika të ka ndryshuar, për mirë a për keq, gjeje vetë.

Edhe një i vetëm sikur të protestojë, nëse kauza është e drejtë, ia vlen. Se sa e madhe ishte protesta, e tregoi reagimi i medias ndërkombëtare dhe këtu merr fund diskutimi, aq më tepër që qeveria e tregoi hapur frikën e saj, edhe para protestës, edhe gjatë protestës. Para protestës u përpoq ta denigrojë, t'i pengojë njerëzit, t'i keqinformojë, të hapë frymën se do të ketë dhunë gjatë protestës. Ju e patë vetë sjelljen, madje edhe Kryeministri me ministrat ikën për të mos qenë prezentë.

Kauza është nga më të rëndësishmet: kërkojmë dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, i cili ka vëllanë të përfshirë në rrjetin ndërkombëtar të drogës. Çfarë po kërkojmë? Po kërkojmë dinjitet qeverisës, nuk po kërkojmë ta lini qeverisjen dhe të vijmë ne, por kërkojmë që qeverisja juaj të përfaqësohet me njerëz dinjitozë, që të mos kenë lidhje të tilla dhe i keni mundësitë që të keni njerëz të papërfshirë në trafik ndërkombëtar droge. Nuk është serioze për një vend që dy ministra të brendshëm rresht, njëri pas tjetrit, të jetë në një gjendje të tillë. Ja, këtë po kërkojmë të korrigjohet në mënyrë që të na hapen negociatat. A ka kauzë më të madhe se sa opozita të japë kontributin, të ushtrojë presion që të plotësohen kushtet për hapjen e negociatave?

Sa për gazetarin Bledi Kasmi, mendoj se nuk është serioze të thuhet se e goditën protestuesit me gurë, aq më tepër të thuhet kjo në Komisionin e Medies. Detyra e gazetarit është të raportojë ngjarjen.

Gazetari duhet të jetë atje, te rreshti i parë. Gazetarë të shquar, që kanë ndjekur luftëra, janë vrarë, kanë humbur jetën për të raportuar lajmin. Detyra e Bledi Kasmit ishte të rrinte atje dhe të ndiqte ngjarjen. Kjo është detyra e të gjithë kolegëve të tij gazetarë, e shoqatave, edhe e Komisionit të Medias, që të dalë në mbrojtje të Bledi Kasmit. Është e turpshme për shoqërinë tonë se ku kemi degraduar që Unioni i Gazetarëve fle, ka frikë, sepse i shërben qeverisë dhe nuk del në mbrojtje të kolegut, të cilin e goditën dhe e gjakosën keq, sikur të ishte në betejat andej nga Siria. Nuk është serioze që Komisioni i Medies mos ta ngrejë këtë shqetësim, sidomos kur shohim se ku është katandisur media në Shqipëri, ku pjesa dërrmuese e saj është kthyer në dajre të qeverisë dhe shumë pak zëra të pavarur kanë ngelur.

Është e turpshme mendoj unë dhe nuk e kuptoj se çfarë do të thotë Autoriteti, që ka mbyllur një portal se shkruan kundër qeverisë. Po ku jemi këtu? Në komunizëm? Në Rusinë e Putinit? Atje i mbyllin portalet, atje i vrasin gazetarët, një e vrasin në Rusi, ja para disa ditësh e vranë një gazetar kritik ndaj Putinit, e çuan në Ukrainë dhe e vranë. Edhe ne drejt kësaj rruge do të shkojmë?

Prandaj ne duhet të reagojmë, të reflektojmë dhe pavarësisht se jemi në anë të ndryshme të spektrit politik, duhet të ruajmë disa norma, të cilat janë veshja demokratike e shoqërisë, që ne pretendojmë të ndërtojmë dhe drejt së cilës kërkojmë të shkojmë, që është BE-ja.

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Spaho!

Më kanë ngelur 2 apo 3 deklarata dhe kërkesa për dëgjuesin e së hënës në tavolinë. Ju bëj thirrje edhe një herë që ta firmosni deklaratën, se do t'ju bënte nder të gjithëve. Në fakt, në referencë të asaj që tha Milva, e cila iu referua raporteve të ndërkombëtarëve, unë nuk e di se cilit raport iu referua për lirinë e medias, se të gjitha raportet e kanë me përkeqësim raportin për mediet në Shqipëri. Dy të fundit që dua të përmend janë raporti i DASH-it për të Drejtat e Njeriut 2017, i cili citon: “Kufizimet në lirinë e shprehjes dhe të shtypit, përfshirë edhe autocensurën dhe frikësimin e gazetarëve shkaktuar nga interesat politike dhe financiare”, është njëri prej problemeve të ngritura, dhe “Korrupsioni i përhapur në të gjitha degët e qeverisë” është tjetri, të publikuara këto pak javë më parë. Gjithashtu, referuar *Reporters Without Borders*, ka përmendur për herë të parë Kryeministrin Edi Rama, i cili ushtron presione dhe shantazhe ndaj gazetarëve dhe ndaj medieeve, duke i fyer, duke i përçmuar dhe duke i quajtur edhe medie kazani. Nuk ka ndodhur ndonjëherë më parë që të përmendet Kryeministri Edi Rama si dhunues verbal, psikologjik dhe shantazhues ndaj gazetarëve dhe ndaj medieeve. Meqenëse kanë mbetur vetëm 28 ditë nga vendimi për hapjen e negociatave, ne si opozitë jemi të vendosur që të ndihmojmë në këtë drejtim, ndaj

jemi këtu në mbledhjet e komisioneve parlamentare, sepse dëshirojmë me çdo kusht dhe sa më parë hapjen e negociatave, sepse janë qytetarët shqiptarë ata të cilët do të përfitojnë nga kjo.

Keni 28 ditë kohë për të reaguar, për të dëshmuar që keni filluar të plotësoni një e nga një kriteret, 28 ditë kohë që të filloni të dëshmoni se e keni seriozisht me luftën ndaj krimit, 28 ditë kohë për të dëshmuar se e keni seriozisht reformën në drejtësi dhe luftën ndaj korrupsionit, pavarësisht se çdo akt që ju po bëni dëshmon krejt të kundërtën, sepse jeni ju ata, Kryeministri juaj, qeveria juaj dhe kjo maxhorancë që nuk e doni hapjen e negociatave.

Lirimi i Sajmir Tahirit ishte ditë e zezë për drejtësinë dhe për Shqipërinë dhe jo vetëm nuk ka ndihmuar, por përkundrazi, kam frikë që po i vë vulën rrugëtimit të Shqipërisë në hapjen e negociatave dhe integritit të BE.

Milva Ekonomi – Sajmir Tahiri, nuk u lirua, është prapë i pandehur.

Albana Vokshi – Milva, ato teatrot, skenat dhe ato marrëveshjet Rama-Tahiri, Xhafaj ju i dini më mirë se ne, ndaj unë jam këtu për t'ju kujtuar se keni 28 ditë kohë. Të paktën distancohuni ju nga këto marrëveshje të errëta dhe mos u bëni palë më krimin! Distancohuni nga këta ministra! Keni dy ministra, njëri pas tjetrit, që na kanë vënë vulën e zezë të gjithë ne shqiptarëve në të gjitha kancelaritë europiane dhe më tej. Vetëm këto janë çështjet që diskutohen në çdo tavolinë ku është Shqipëria: krimi, droga, një ministër, që ishte i lidhur me kushërinjtë dhe bënte trafik droge, tjetri e mbuloi vëllain për 15 vjet që të mos kryente dënimin e formës së prerë 7 vjet e 2 muaj nga drejtësia italiane dhe është subjekt i Ligjit Antimafia.

Pse nuk flisni për trafikimin e ligjeve? A ju bën nder kjo? A na afron ne me BE-në?

Milva Ekonomi – Kemi një prononcim të BE-së për nenin 4/139 F.

Albana Vokshi – Mos u fshini pas deklaratave, sepse unë dhe ti e dimë shumë mirë si miratohen ligjet, raportet, se çfarë ndodh pasi votohen nen për nen dhe në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, nuk të ndërhyra, prandaj mos më ndërhy!

Milva Ekonomi – Mbi ato deklarata punohet, por, në fakt, një nga gjërat e rëndësishme që duhet të diskutojmë është grumbulli i madh i drogës gjatë një viti, si dhe moslejimi i Shqipërisë që të përdoret si kanal droge.

Albana Vokshi – Keni 28 ditë kohë, dhe ne do të jemi këtu, si opozitë për t'ju kujtuar. Filloni dëshmoni që e keni seriozisht, se po luftoni seriozisht krimin, që nuk jeni palë me të! Vetëm kështu do ta çlironi pengun, vetëm kështu nuk do të bëheni pengesë, sepse ju jeni pengesa e vetme

për shqiptarët, për fëmijët tanë. Ju jeni pengesa, ndaj, si deputetë keni kohë 28 ditë që të distancoheni nga dhuna. Stop dhunës ndaj gazetareve nëpër komisione! Stop dhunës ndaj gazetarëve që denoncojnë lidhjen e qeverisë me trafikun! Stop shantazhit që po i bëni gazetarit Olldashi! Stop dhunës fizike ndaj kryeredaktorit apo gazetarëve të tjerë, të cilët raportojnë minutë pas minute reagimin e popullit ndaj kësaj qeverie të bërë të bërë palë me krimin! Deri atë ditë, për 28 ditë me radhë, ne do të jemi këtu që t’jua kujtojmë se duhet të filloni të plotësoni kriteret një më një dhe deri atë ditë unë nuk mendoj se në këtu komision ne do të diskutojmë çështje të tjera përtej kësaj.

Kështu që unë, bashkë me kolegët e mi do të largohemi, atëherë kur ju të jeni gati të filloni të diskutoni seriozisht për lirinë e medias dhe t’i thoni “stop” dhunës ndaj gazetareve. Hajde të flasim seriozisht për lirinë e medias! Distancohuni nga dhuna ndaj gazetarëve dhe do të jemi këtu prezent nga fillimi deri në fund. Deri në atë kohë unë nuk mendoj se mund të ketë çështje të tjera për të diskutuar.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2018, ora 11:30

Drejtton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 8, 14 dhe 15 maj 2018.
2. Diskutimi i materialeve të AMA-s, dërguar komisionit për shqyrtim.
 - Propozimi i AMA-s “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9584, datë. 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj.””
 - Propozimi i AMA-s për ndryshim në strukturën dhe organikën e AMA-s.
 - AMA i është drejtuar Komisionit për mendim në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun, si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar.”

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Adelina Rista , Bujar Çela, Almira Xhambulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka.

Të ftuar:

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,

Erjona Rusmailli - drejtore e Burimeve Njerëzore në AMA,

Sara Xhumbari – drejtore e Drejtorisë Juridike në AMA.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi - Mirëdita!

Rifillojmë mbledhjen.

Sot, në mbledhjen e datës 30.05.2018, kemi në rendin e ditës këto çështje:

Çështja e parë është miratimi i procesverbaleve të datës 8,14 dhe 15 maj.

Nuk e di, a i keni lexuar? Jeni dakord?

Dakord me procesverbalet. Miratohen.

Çështja e dytë e rendit të ditës është një propozim i AMA-s drejtuar Komisionit tonë, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet, strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj””.

Ne, si komision, edhe në mbledhjet e kaluara kemi rënë dakord t’ia çojmë këtë propozim të AMA-s Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave për të dhënë mendimin e tyre. I kemi kërkuar Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit të përgatisë shkresat. Ata e kanë përgatitur shkresën, që është marrë nga ne dhe është çuar për mendim. Ndërkohë, nuk ka ardhur akoma përgjigjja. Kështu që do t’ju vëmë në dijeni sapo të ketë një përgjigje për këtë shkresë.

Çështja e dytë është propozimi i AMA-s për një ndryshim në strukturën organike të AMA-s. Edhe për këtë çështje ne kemi bërë detyrën tonë si komision. E kemi kaluar te Departamenti i Administratës Publike dhe ata kanë ranë dakord në parim. Ajo që na takon tani në komision, është të marrim një vendim për këtë strukturë që ka propozuar AMA. Arsyeja pse AMA ka propozuar këtë strukturë është përcaktuar edhe në relacionin që na keni sjellë ne, por unë do të doja nga kryetari, zoti Gentian Sala, të thoshte shkurtimisht dy arsye pse kërkohet ndryshimi i strukturës. Ne, në fakt, duke bërë edhe kalimin te DAP-i, jemi njohur me arsyen, por shkurtimisht, sa për ta regjistruar në procesverbal.

Gentian Sala - Ndryshimi i strukturës, së pari, është bërë për arkivistin, sepse Drejtoria e Arkivit ka bërë një kontroll tek institucioni ynë dhe në bazë të urdhrave dhe vendimeve që kanë ata, rezulton se duhet të ketë më shumë punonjës se çka, kurse çështja e teknikës është çështje e ngritur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes, duke qenë se Studioja e Monitorimit punon 24 orë dhe ka regjistrime që prej vitit 2007, por që prej vitit 2014, televizionet kombëtare, televizionet informative i kanë *non stop* të ruajtura regjistrimet, në gjendje shumë të mirë dhe kanë nevojë për

dy teknike në detyrë. Pra, janë të tria pozicione teknike. Kërkesat kanë ardhur nga administrata dhe Bordi i ka gjykuar si të drejta.

Mund të vazhdoj edhe për dy pikat e tjera, apo...?

Milva Ekonomi – Për pikën e parë ne nuk ju ndihmojmë dot akoma, sepse po presim një përgjigje nga Këshilli i Ministrave.

Pika juaj e tretë është një kërkesë për projektvendimin “Për miratimin e listës së gjërave me rëndësi të madhe për publikun, si dhe mënyrat e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar”.

Para se të kalojmë te kjo çështje, për të cilën kemi relator zotin Musa Ulqini, a biem dakord për strukturën organike të AMA-s? E votojmë?

Dakord? Dakord.

Për çështjen tjetër, për miratimin e listës së ngjarjeve, zoti Ulqini, do të shtoni diçka?

Musa Ulqini – Kam vetëm dy fjali.

Duhet përgëzuar AMA për materialin që ka sjellë, sepse është diçka që lidhet me standardet e ligjit dhe me direktivat e BE-së dhe komentet për televizionin pa kufi. Kështu që është në kohën e duhur. Është gjëja e duhur dhe ne duhet ta miratojmë.

Milva Ekonomi – Doja të thosha edhe diçka për këtë gjë, që, në fakt, mund të na i thoni edhe ju, por kjo është edhe një kërkesë që vjen në zbatim të direktivave të Bashkimit European dhe ne përafrojmë legjislacionin tonë në fushën e medias, më shumë me direktivat e Bashkimit European. Shembulli që ju keni marrë (në fakt, edhe anëtarët e komisionit janë vënë në dijeni për këtë) vjen edhe nga vendet e tjera europiane, si: Austria, Franca, Italia, Danimarka, ku ata kanë një listë ngjarjesh, për të cilat vendosin të jenë pa pagesë për publikun. Mbase mund të na i rreshtoni ngjarjet që ka marrë përsipër Shqipëria. Do të ishte mirë t’i dëgjonte edhe publiku.

Gentian Sala – Po. Është dokument shumë i rëndësishëm, është kërkesë e ligjit, është kërkesë e strategjisë së miratuar nga AMA për këtë vit, është edhe direktivë, siç thatë edhe ju.

Ne kemi bërë, le të themi, kërkesa maksimaliste. Kemi vënë shumë ngjarje. Ka shtete që kanë pak, ka që kanë... Ne jemi maksimalë në momentin që flasim. U është çuar për mendim operatorëve, sikurse edhe Komisionit të Medies. Brenda 60 ditëve do të marrim mendimin dhe më pas Bordi i AMA-s do të gjykojë dhe do të vendosë. Për momentin kemi thënë maksimalen e mundshme që gjykojmë. Sikurse thatë edhe ju, edhe gjatë pushimit ju mund të shtoni, edhe operatorët mund të shtojnë apo të thonë kërkesa për heqje apo rimendim. Është e drejta e tyre. Për

shembull, që tani kemi pasur operatorë për ndeshjet e kampionatit shqiptar. Nuk e kanë sjellë ende zyrtare, por kjo nuk na ndihmon ne. Ka vende që i kanë, ka vende që nuk i kanë. Kjo listë hap debate dhe është normale të gjykohet. Ne kemi vënë maksimalen. Mendoj se këtu duhet të jemi si administratë, do t'i gjykojmë ne operatorët, do të takohemi me ta. Ju jeni aktori kryesor te kjo listë për të gjykuar. Pra, kjo është faza, që nuk mendoj se do miratim, kërkon mendim.

Nora Malaj – Mund të bëj një pyetje?

Cila metodologji orientohet në kuadër të vlerësimit apo të gjykimit të rasteve, që edhe ne këtu të bëjmë vlerësim dhe gjykim, duke u nisur nga standardet e BE-së, por edhe nga ligji, që në vlerësimin tonë të kemi formatin e metodologjisë, që rast pas rasti, edhe për ngjarje kombëtare apo ndërkombëtare për identitetin apo promovimin, të dimë si mund të ndihmojmë për listimin e tyre.

Gentian Sala – Mund të flasë drejtoresha juridike për këtë.

Sara Xhumbari – Përshëndetje!

Përcaktimi i listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe ...

Gjatë procesit të punës ne jemi orientuar kryesisht te ligji. Ligji organik nr. 97/2013 përmban përkufizimin cilat janë ngjarjet që mund të konsiderohen me rëndësi të madhe dhe duhet të plotësohen të paktën 2 nga 4 kushtet e mëposhtme. Në rastet kur për ngjarjen ka interes të veçantë dhe të përhapur në territorin e vendit, ngjarja gëzon njohje të gjerë nga publiku; ka një ndikim kulturor drejt të gjithë publikut; nuk ka përmbajtje partiake; përfshin pjesëmarrjen e skuadrës kombëtare në evente sportive ndërkombëtare dhe historikisht është transmetuar pa pagesë përmes televizionit. Ligji parashikon këto 4 kërkesa që shërbejnë si orientim për përgatitjen e listës, e cila është përcjellë për mendim pranë komisionit tuaj.

Milva Ekonomi – Në këtë listë janë marrë parasysh ngjarjet ekskluzive të RTSH-së?

Sara Xhumbari – Nuk janë përfshirë ngjarjet ekskluzive të RTSH-së. Bëhet fjalë për bëhet fjalë për *Euro Song*-un, sepse përfaqësuesi i shtetit shqiptar është fitues i festivalit që realizohet nga RTSH-ja. RTSH-ja është anëtare e EBU-së dhe nuk e kemi përfshirë në listë. Megjithatë, lista mund të amendohet. Ne jemi duke pritur mendim nga palët e interesuara. Po ashtu, sipas kërkesës së ligjit, projektvendimi i është përcjellë për mendim ministrisë që mbulon kulturën, arsimin, turizmin dhe jemi ende në pritje të ngjarjeve që mund të na propozohen për t'u përfshirë në listë.

Milva Ekonomi – Pra, ju nuk jeni gati për të marrë një miratim final nga komisioni ynë. Do të sillni edhe ngjarjet e tjera që propozohen nga ministritë e linjës dhe nga operatorët dhe më pas do të kërkonin një aprovim final?

Sara Xhumbari – Jo, ne ua kemi sjellë për mendim, sepse jemi në fazën e këshillimit publik. Miratimi i takon një faze të mëvonshme.

Milva Ekonomi – Sipas komenteve që ka sjellë Shërbimi i Monitorimit në Kuvend, ne i kemi parë. Natyrisht, ju përgëzojmë për iniciativën për të zgjeruar listën! Për këtë arsye do të jemi vazhdimisht në komunikim. Përgjigjen për këtë çështje do ta merrni me shkrim nga komisioni ynë, që ta keni pjesë të dokumentacionit teknik që mbani pranë institucionit tuaj. Do të jemi në kontakt për këtë gjë.

Ne kemi ende dy çështje për diskutim final: kriteri i ri i pagave, që, nëse do të miratohet, do të shikohet nëse do të ketë ndonjë këshillim nga Ministria e Financave dhe Këshilli i Ministrave dhe struktura juaj e re, sipas kërkesave tuaja, është miratuar nga komisioni edhe sipas propozimeve që ka sjellë Departamenti i Administratës Publike.

Për çështjen tjetër do të mbetemi në kontakt.

Urdhëroni!

Gentian Sala – Për çështjen e pagave, për saktësim, bëhet fjalë për pagat e anëtarëve të bordit.

Milva Ekonomi – Na keni dërguar shkresën, e kemi parë. Ju na keni sjellë edhe përshkrime nga vendet e rajonit dhe ne i kemi bërë kërkesë Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave pikërisht mbi bazën e justifikimit të kërkesës, nëse mund të quhet kështu, duke parë eksperiencën të ngjashme. Jemi shumë të qartë për këtë.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA